

KRIJIMI I NEOLOGJIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE GJATË TRANZICIONIT DEMOKRATIK

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti I Europës Juglindore, Tetovë, Maqedoni
M. Ibrahim@See.Edu.Mk

AKTET V, 4: 709-713, 2012

HYRJE

Gjatë 20 viteve të fundit të tranzicionit demokratik, plot ngjarje të trazuara, gjuha shqipe është pasuruar me shumë fjalë të reja. Ka edhe fjalë të tilla, të cilat tashmë nuk përdoren më. Ndër faktorët kryesorë që ndikuan për të pasur plot fjalë e terma të rinj, janë edhe krizat ekonomike e politike, të cilat kanë ardhur njëra pas tjetrës, si: lindja e krimit të organizuar, aderimi i vendit tonë me BE-në dhe lufta për përvetësimin e fondeve evropiane e procese të tjera, karakteristike për dy dekadat e fundit.

Në historinë tonë të re ka dy periudha të tilla. Njëra është menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, kur u ndryshua sistemi shoqëror dhe përkatësisht qëndrimet e njerëzve. Në atë kohë në gjuhën shqipe hynë shumë fjalë, të cilat i pasqyruan këto ndryshime. Periudha tjetër e lindjes së shumë fjalëve të reja në gjuhën tonë është pas vitit 1989, kur në trevat shqiptare nisi rruga e ekonomisë së tregut. Pikërisht gjatë 20 vjetëve të fundit gjuha jonë u pasuarua me shumë neologjizma.

Ka shumë mënyra për krijimin e neologjizmave në gjuhë. Pa mëdyshje mediet kanë një ndikim shumë të madh, sepse ato jo vetëm i përhapin risitë në gjuhë, por dhe shumë shpesh krijojnë fjalë e shprehje të reja. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për politikanët e personat publikë. Shumë shpesh jemi dëshmitarë se si ata përdorin shumë huazime, ose përdorin në mënyrë të gabuar fjalë shqipe, duke ndryshuar pa rregull kuptimin e tyre.

I. Mjetet fjalëformuese në krijimin e fjalëve të reja

Kjo dukuri më e theksuar është me përdorimin e mjeteve fjalëformuese, si me **parashtesat**: **anti-**: *antikontrabanda*; **neo-**: *neoshqiptarizma*; me **prapashtesat**: **-iada**: *brucoshiada, ballkaniada, roshomoniada, fintiada, universiada, goliada, Iliriada, patadiada, Saliada, autogoliada*; **-mania**: *qeveriomania, absurdomania, apartmania, mankeymania, informania, grandomania* (vepër e Ylber Lilit), *Arnautomania* (vepër e Nikollë Lokës), *Euro(p)mania, bibliotekomania, Jugomania, administrator-mania, Facebook-mania, folkomania, anketomania* etj.; **-izimi**: *gjeorgjizimi, idiotiz(i)mi; krahinorizimi, romskrimizimi; zveçanizimi, turboshkombëtarizimi, ekolonializimi, Sanaderizim; -izmi*: *Fatmirizmi, Thaçizmi, Esatizmi, konsumerizmi, dekomunistizmi*; **-izëm**: *Enverizëm, Katakliizëm; haxhiqamilizëm*; **-ation**: *Berishation* (Berisha +tion); **-lend**: *Fintolend* (rrjedh nga fjala frënge "feint", e cila ka kuptimin e një lëvizje a manovre që pritet të ndodhë, por befasisht ndodh një lëvizje krejtësisht tjetër ose nuk ndodh asgjë; merret si sinonim i mashtrimit), *Dejtonlend*; **-land**: *Dembeland, Ajvarland*; **-kracia**: *meritokracia, pornokracia, imazhokracia, Gruevskokracia, partokracia, demo(n)kracia, eurokracia, ad'hokracia, shkërdhatokracia, imazhokracia*; **-logji**: *fishtologji, pelazgologji, vidiologji, barkologji, llafologji, ndyroglogji*; **-stan**: *Serbistan, Albanistan* (vepër e Andrea Stefanit),

absurdistan, pokeristan, pishmanistan, Hadistan, Salistan, folkloristan; -isht: shqipisht; -uc: Stalinuc (komentim nga vargjet e Arshi Pipës “Albanian stalinizëm”).

II. Përngjitja e fjalëve në një tërësi (blende)

Ndër dukuritë e tjera, vëmendje tërheq edhe një proces i ri sociolinguistik, i motivuar për të ndërtuar fjalë të reja në gjuhë. Këto fjalë krijohen me anë të shkrirjes, bashkimit ose kontaminimit; në aspektin terminologjik ndërkombëtar për këto rëndomë përdoret termi **blende**. Bëhet fjalë për përngjitjen e dy fjalëve ose të pjesëve të tyre në një tërësi të re, duke u përputhur me segmentet e tyre formale; ajo paraqet kombinim të pjesëve që kanë hyrë në atë përbërje (Ibrahimi, 2008,192). Paraqitja e blendeve nuk është njësoj intensive në të gjitha fushat, por si dukuri paraqitet në shumë gjuhë. Duhet të përmendim që shumë blende me prejardhje ndërkombëtare nuk është qëllimi t'i huazojmë, por të shohim që ky proces, deri pak para i panjohur, sot ka marrë një hov shumë të madh dhe paraqet mënyrën më të gjallë të krijimit të fjalëve të reja. Me shembujt ndërkombëtarë kemi marrë vetëm inspirimin si një lloj modeli gramatikor e deri diku edhe si një qëndrim psikologjik, që mund të zgjerohet me blende nga brumi gjuhësor yni dhe në rrethin tonë shoqëror. Të përmendim disa blende që janë marrë nga gjuhët e huaja: *demokracia, katastrojka* (nga rusishtja), *rurbane, automat, bankomat, kafemat, kartomat, parkomat* (nga anglishtja), *teuro* (gjerm. *Teuer* “shtrenjtë” + Euro); fjala e fundit ka kuptim ironik, për shtrenjtimin e përgjithshëm që ndodhi me kalimin e markës në euro. Kjo fjalë më 2002 u zgjodh si fjalë e vitit në Gjermani. Blendet e para u afirmuan në skenën politike gjatë ndryshimeve të mëdha, që e përshkuan jo vetëm vendin tonë, por edhe tërë Ballkanin.

Sipas hulumtimeve tona, prodhuesit e këtyre blendeve mund të ndahen në 3 grupe krijuesish: **adoleshentët** (për zbatimje), **gazetarët** (për të tërhequr auditorin) dhe **ekspertët e marketingut** (për të tërhequr klientët për prodhimet a për shërbimet e tyre).

Modele krijuese

Në këtë pjesë do të paraqesim mekanizmat formalë të përngjitjeve. Këtu termi *fjalë* përfshin edhe akronimet e shkurtesat tjera. Si pjesë të fjalës trajtohen edhe morfemat, rrokjet ose shkronjat. Zakonisht modifikohet njëra pjesë e njëres fjalë me pjesën tjetër të fjalës së dytë. Në shumë raste, theksimi me shkronja të mëdha është e kufizuar vetëm në formën e shkruar, pasi në të folur humbet krejtësisht.

1. *Modeli i parë (klasik)*: pjesa e parë e njëres dhe pjesa e dytë e fjalës së dytë shkrihet në një tërësi: *Albglis* (albanian + english), *Euroslavia* (Europa + Jugosllavia), *demokracia* (demokracia + diktatura), *demonokrate* (demon + demokrate), *Drakullesku* (Drakulla + Caushesku), *falciklopedia* (falcifikim+ enciklopedia), *kleptokracia* (kleptomani + demokracia), *xhamajrikan* (Xhamajka + amerikan), *partokratia* (partia + demokracia), *Kosoft* (Kosova + Majkrosoft), *Eurabia* (Europa +Arabia), *Eurokracia* (Europa + demokracia), *agromak* (agronom + ahmak).

2. *Modeli i dytë*: pjesa e parë e njëres dhe pjesa e parë e fjalës së dytë shkrihet në një tërësi: *Alsat* (Albanian+satelit), *Albsig* (albanian+sigurimi), *Albakos* (Albania + Kosova), *AlbUSA* (Albania + USA), *Boxalb* (boxing + albanian), *Digitsat* (digital + satelit), *Digitalb* (digital + albanian), *Kosmak* (Kosova + Makedonija), *Eurosig* (Euro + sigurimi), *Albaglobal* (Albania + globalizëm), *dokufest* (dokumentar + festival).

Mjaft interesante janë edhe përngjitjet që u janë bërë emrave personale: *Ridi* (Rifat + dëshira), *Flutag* (flutura + agim), *Floreta* (Florian + Etleva); *Ergan* (Erdhi + Ganiu), *Mirela* (Mirë + Labëri), *Selyn* (Selimi + ynë), *Marenglen* (Marks + Engels + Lenin), *Agjitprop* (agjitim + propagandë).

3. *Modeli i tretë*: a) Përngjitja e tërësishme e fjalës së parë me pjesën e dytë të fjalës së dytë: *llumokraci* (llum + demokraci), *shqipglis* (shqip + english), *Ndokanator* (Ndoka + terminator), *Manupedia* (MANU + enciklopedia), *falciklopedia* (falc + enciklopedia), *respektikë* (respekt + frikë), *monoklopedia* (mono + enciklopedia), *mikropedia* (mikro + enciklopedia), *bleferendum* (blef + referendum), *goleador* (gol + toreador); *VeliLeaks* (Veli + WikiLeaks), *DickyLeaks*

(WikiLeaks); *MartyLeaks* (**Marty** + WikiLeaks), *fantastik* (**fanta** + fantastik). b) Përngjitja e tërësishme e fjalës së parë me pjesën e parë të fjalës së dytë: *showbiz* (**show** + **biznes**), *Albaniasat* (**Albania** + satelit).

4. *Modeli i katërt*: Përngjitja e pjesës së parë të fjalës së parë me pjesën e tërësishme të fjalës së dytë: *Albadigital* (**Albanian** + **digital**), *Albaglobal* (**Albanian** + **global**), *Albakopie* (**Albanian** + **kopie**), *Albashare* (**Albanian** + **share**), *Albatrans* (**Albanian** + **trans**), *Albauto* (**Albanian**+**Auto**), *Albducros* (**Albanian** + **Ducros**), *albemigrant* (**Albanian** + **emigrant**), *albevangelist* (**Albanian** + **evangelist**), *Albfriend* (**Albanian** + **friend**); *Albislam* (**Albanian** + **Islam**), *Albqeramikë* (**Albania** + **qeramikë**), *Albshkenca* (**Albanian** + **shkenca**), *Albstation* (**Albanian** + **station**), *albstudent* (**Albanian** + **student**), *Informania* (**informacion** + **mania**), *telenovelë* (**televizor** + **novelë**), *telemarketingu* (**televizioni** + **marketingu**), *kulturizmi* (**kulturë** + **turizmi**), *narkotrafiku* (**narkomania** + **trafiku**).

5. *Modeli i pestë*: Njëra fjalë gjendet në tjetrën, e cila medoemos të theksohet: *Albangle* (**alban** – **angle**), *apartmania* (**apartman** + **mania**), *fotografia* (**fotograf** + **grafia**), *kakademik* (**kaka** + **akademik**), *kameleopard* (**kameleon** + **leopard**), *profaraon* (**profa** + **faraon**), *Ballkankan* (**Ballkan** + **kan**), *anarkeologji* (**anarki** + **arkeologji**).

6. *Modeli i gjashtë*: Kategori më vete dhe pa ndonjë analizë, kryesisht përfshihen blendet e ndryshme ndërgjuhësore, për fjalë të përziera shqip-anglisht, ndonjëherë edhe vetëm anglisht. Mund të krijohen nga gazetarët, pra mediet publike janë burim i pashtershëm i krijimit të fjalëve të tilla, të përziera, që shpesh herë përdoren në titujt e artikujve dhe të manifestimeve të ndryshëm: *dokufest* (Edicioni i dhjetë i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër, “Dokufest”, Prizren); *kulturizmi*; *Akupunkultura*; *falsikopedia*.

II. Përngjitja e fjalëve lidhur me emra njerëzish dhe vendesh

Në një ndërmarrje vjen një përgjegjës i ri i brigadës dhe ata i thonë mbiemrat e tyre, sapo njihen, duke dalë një përkim i rastit: *Çelsula*,

Çelmeta, *Çelaga*. Përgjegjësi atëherë tha: *U pa puna, edhe unë nga Adhami do ta bëj Çeladhami!* (Lloshi, 2001,124); te “Çipi i palaçove”(1922) Faik Konica luan me tri trajta të emrit të kontinentit *Avrupa*, *Evropi*, *Evropa*, për ata që shtiren se janë evropianizuar (Lloshi, 2001, 56); edhe Q. Buxheli përdor *Faraonë dhe Firaunë*, kurse A. Abdihoxha *kapelamëdhenjtë, rrogamëdhenjtë*. Nga veb-faqja kontraverse WikiLeaks, lindën disa fjalë të reja duke marrë emrat e personave kontravers, si: *VeliLeaks* (Veli Ramkoski); *DickyLeaks* dhe *MartyLeaks* (Dick Marty). Një përdorim të gjerë po gjejmë sot në shtypin shqiptar edhe një numër kompozitash që kanë si gjymtyrë të parë një temë emërore, që shënon emrin ose mbiemrin e një qeveritari të lartë, kryesisht të kryeministrit; p.sh. *nanokorrupsioni*, *nanomafia*, *nanopushteti*, *nanoqueveria*, *nanotrafiku* (Metani, 2010, 471). Në një kolumnë edhe publicisti Edmont Tupja luan me tri trajta të emrit të Edi Ramës: *ramistë*, *rameskë*, *ramoid*, si dhe *ramëkriza* (Metani, 2010, 471). Nuk mbetet anësh edhe kryeministri aktual i Shqipërisë, Sali Berisha: *saliada*, *berishation*, *salistan*, si dhe *saligërdeci* (Metani, 2010, 471). Ja edhe disa tjera: *Sllobonostalgjia*, *Thaçizmi*, *Gruevskokracia*, *Esatizmi*, *Sanaderizim*, *Ramëkriza*, *Enverizëm*, *Kemalizmi*.

Nga diskursi politik: Për krijimin e fjalëve të përziera mjaft popullarizues është edhe diskursi politik. Këto shpesh janë krijime të shënuara me mashtime të segmenteve të caktuara (mund të jenë fjalë ose shkurtesa, më shpesh akronime). Përdoren kryesisht shkronja të mëdha, duke dhënë një efekt të veçantë vizual; p.sh. *S’Ban*, *S’Ki*, *S’Mun*, *Falciklopedia*, *EncikloPADI*, *Enciklopedia*. Meqë kjo lidhet me Akademinë e Shkencave të Maqedonisë (MANU), lindën edhe këto krijime: *MANUpedia*, *MANU-SANU*, *MANITU*, *MANU-fakt* (ura); *AKANEMIKët*. Raste të tjera kemi edhe te fjalët: *DEPUTETTTT?! (Kush do të bëhet DEPUTETTTT?!)*, *fUND*, *YUNMIK* dhe *UNMIKolonializëm*, *Id – Entiteti*, *Dis-kursi*; Ahtisari = *Harçenko Ishinger Vizner* +; *kleptokracia*, *demokratura*, *IDEAle*, *referenDUM*. Shumë fjalë me përmbajtje politike kanë lindur edhe me anë të kombinimit të numrave me fjalë: *12-KS-44*,

Virusi U1N2M4I4K, Virusi E1U2L4E4X, 12:44
Time's up UNMIK go Home, Eulexilium 1244 mg.

Nga ekspertët e marketingut: Krijime të pazakonta verbale janë edhe blendet që i gjejmë në botën e reklamave, më shpesh me theks të veçantë të përdorimit të grafikëve dhe të shenjave të ndryshme, ndërsa nga aspekti gramatikor zakonisht përdorimi i mënyrës urdhërore. Me shenjën e euros €, kemi këto emërtime: *€kon:ference*, *€urosig* dhe *€uroSpa*, *€kolonializimi*, *€misioni i autonomisë*; Shenjën @, e takojmë më tepër nëpër reklama: *freem@il*, *@net* (ardhmëriaNET.com), *@cafe*, *blet@net*, *M@qedonia*, *@xpert* – *ekspert*, një klub muzike është emërtuar *Amon Mra* (nga perëndia e diellit tek egjiptasit e vjetër Amon Ra).

Përfundim

1. Nuk është e rastit që gjatë 20 viteve të fundit të tranzicionit demokratik, plot ngjarje të trazuara, gjuhët e Ballkanit, por në përgjithësi edhe gjuhët e tjera, janë pasuruar me fjalë të reja. Kështu, të themi që gjuha bullgare është pasuruar me mbi 5 mijë fjalë të reja. Ka edhe fjalë të tilla, të cilat tashmë nuk përdoren në fjalorin tonë, – thotë Diana Bllagoeva, përpiluese e edicionit të fundit të "Fjalorit të fjalëve të reja në gjuhën bullgare", i cili do të dalë në tregun bullgar së shpejti. Kurse gjuhëtari serb Ranko Bugarski (2010, 263), nga hulumtimet e tij të bëra nga viti 2006, ka analizuar dhe ka klasifikuar rreth 3200 zhargonizma e 800 blende ose fjalë të përziera. Kjo krejt bashkë formon 4000 njësi leksikore, që po ashtu pritet të dal në treg.

2. Procesi i blendeve në gjuhën shqipe ende nuk ka gjetur mbështetjen e duhur, megjithatë me të madhe funksionon nëpër reklama, programe, emërtime të kanaleve televizive dhe të institucioneve të caktuara private etj., si p.sh. *albsat*, *albsig*, *albskenca*, *albglish*, *shqipglish* etj., mirëpo për mbledhjen dhe analizimin e tyre është bërë shumë pak. Pikërisht kjo na ka shtyrë të merremi me shqyrtimin dhe me sqarimin e kësaj dukurie komplekse, këtu edhe qëndron qëllimi kryesor që t'i mbledhim dhe t'i studiojmë jo vetëm zhargonizmat, por edhe të gjitha krijimet e reja gjuhësore dhe në këtë mënyrë të

zbulojmë se si gjuha me potencialet e veta krijuese përshtatet me dukuritë e ndryshueshme në shoqëri. Do të duhen vite për t'u mbledhur, porse çdo ditë lindin një numër i madh blendesh si proces që i përgjigjet kohës e nevojave të caktuara.

LITERATURA

- BUGARSKI, Ranko. (2002). *Nova lica jezika*. Biblioteka XX vek:Beograd.
- BUGARSKI, Ranko. (2006). *Žargon*. Biblioteka XX vek:Beograd.
- BUGARSKI, Ranko. (2010). *Jezik i identitet*. Biblioteka XX vek:Beograd.
- DAVUTOGLLU, Ahmet (2009). *Kriza globale /Debate rreth 11 shtatorit*. Logos A: Shkup.
- DEMIRI, S (2009). *Thumbi i fjalës*. Shkup.
- ВЕЛЈАНОВСКА, Катерина. (2009). *Антонимијата и новите зборови во македонскиот јазик*. Зборник на трудови од научниот собир „Културата на јазикот,, одржан 3-4 април 2008,,. Скопје. fq.129-130.
- IBRAHIMI, M. (2008). *Vëzhgime mbi disa dukuri sociolinguistike tek shqiptarët e Maqedonisë e më gjerë*. Në Studime etnolinguistike,folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni. (koautorë V.Bexheti, H.Xhaferi) UEJL:Tetovë.
- IBRAHIMI, M. (2009). *Fjalor i zhargoneve dhe eufemizmave shqiptare*. Interlingua:Shkup.
- IBRAHIMI, M. (2010). *Perifrazat shqipe në kontakt me gjuhët e tjera*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nr. 29/1, Prishtinë.235 - 247.
- KLAJN, Ivan: *Neologisms in present-day Serbian*. U br.26, 89-110. 2001.
- LLOSHI, Xhevat (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Shblu:Tiranë.
- METANI, Idriz (2010), *Gjurmë semantike dhe strukturore në shqipen e sotme nga kontaktet gjuhësore*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nr. 29/1, Prishtinë.469-474.
- NIKOLLOVA, Veneta. (2011). *Për 20 vitet e fundit gjuha bullgare është pasuruar me 5 mijë fjalë të reja*

NAHZI, Fron (2011). *Midis Bronksit dhe Ballkanit*. Botimet Dudaj: Tiranë.

PARLLAKU, Matida (2010), *Reklama si mishërim i kontakteve në gjuhë e mes gjuhë*. Në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Nr. 29/1, Prishtinë.492-503.

РЕЉИЋ, Митра (1995). О неологизмима са социолингвистичког становишта (на материјалу руског језика). Зборник

Филолошког факултета у Приштини 5-6, 235'241.

Gazetat dhe agjencitë: "Koha e Re", "Shqip", "Vetëvendosja", "Zhurnal", "Shqipmedia", "Lajm i fundit", "Fakti ditor", "Lajm", "Sot", "Gazeta Start", "Forum", "Fakti", "Koha",